

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AgriConsult Group” Sh.P.K

Sot me daten 07.11.2023 ne Lushnje, Ortaket themelues,

1. Klaidi BIDO atesia Refat, lindur me date 28.03.1989 ne Durres, me banim ne Lagjja nr. 2 Rr. Karl Topia, pallati 10 Durres, mbajtes i leternjoftimitme nr. 036157115, me nr. personal I90328072B.
2. Daniel SHANDRO atesia Jovan, lindur me date 30.11.1975 ne Lushnje, me banim ne Lagjja Loni Dharmo, Rr. Bulevardi i Palmave Lushnje, mbajtes i leternjoftimit me nr. 034179945, me nr. personal H51130062S.
3. Franco SACCOCCI atesia Giulio, lindur me date 07.12.1963 ne Castro dei Volsci (Itali), me banim ne Contrada Ranetto, 22 int.3 Castro dei Volsci Frosinone Itali, mbajtes i leternjoftimit me nr. 630981, me nr. personal CA32766CH.

vendosen krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “*AgriConsult Group*” sh.p.k,


Shoqëria “AgriConsult Group” sh.p.k, ushtron aktivitetin e saj në bazë të Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, dhe të ligjit Nr.9723 datë 03/05/2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe të gjithë ligjeve që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë dhe pas pajisjes me çertifikatën e regjistrimit dhe Niptin perkates.

Neni 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “**AgriConsult Group**”. Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë statut nga ortaku themelues. Në çdo shkresë të lëshuar nga shoqëria, emërtimi i saj do të shoqërohet me shkurtimin “**sh.p.k**” përpara ose pas emërtimit, shkurtim i cili nënkupton llojin e shoqërisë.

Neni 2
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është ne Lushnje në adresën; Lagjja Skender Libohova, Pasuria me numer 6/11 Z. Kadastale 8572 Lushnje. Hapja e degëve ose filialeve ne qytete të tjera do te bëhet me aplikimin ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit te Bashkise ku shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, ose ne seline qendorere te QKBne Tirane.Miratimi do të bëhet nëpermjet pajisjes se shoqërisë me çertifikatën e regjistrimit perktes te deges apo filialit. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim te Ortakeve. Për këtë ndryshim do të vihen në dijeni organet shtetërore përkatese, për të bërë ndryshimet e duhura.



Neni 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise :

Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit Shqiptar, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke perfshire por pa u kufizuar ne: Import-Eksport, prodhim, ambalazhim dhe shitje me shumice dhe pakice te produkteve per mbrojtjen e bimeve, plehrave kimike dhe agrokimikateve te tjera, farerave e fidaneve, serave dhe pajisjeve per ndertimin e tyre, makinave bujqesore dhe cdo gje qe lidhet me fushen e bujqesise dhe jo vetem. Si dhe çdo aktivitet tjeter qe konsiderohet fitimprures dhe ne interes teshoqerise.

Neni 4
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria mund ta ushtroj veprimtarine e saj per nje afat 10 vjet me te drejte zgjatje afati. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpara këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, por vetëm pasi për këtë të ketë vendosur Ortaku i Vetem i saj.

Neni 5
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqerise “AgriConsult Group” sh.p.k, eshte **100 000 (nje qind mije) leke**, kapital ky i zoteruar nga ortakët e kesaj shoqerie Klaidi Bido, Daniel Shandro dhe Franco Saccoccido te depozitohet ne nje Banke ne Republikën e Shqiperise.

Kapitali eshte 100.000 leke dhe i ndare ne kuota dhe eshte me 3 kuota te barabarta gjithsej me vlere nominale 1 kuote e barabarte me 33333,33 leke, qe perbejne 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise “AgriConsult Group” sh.p.k.

Kuotat e shoqesise ndahen ndermjet ortakeve si me poshte:

1. Ortaku Klaidi Bido 1 kuota e barabarte ne vlere 33333,33 leke
2. Ortaku Daniel Shandro 1 kuota e barabarte ne vlere me 33333,33 leke
3. Ortaku Franco Saccocci 1 kuota e barabarte ne vlere me 33333,33 leke


Neni 6
TRANSFERIMI I KUOTAVE APO NDRYSHIMI KAPITALIT

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie midis trashëgimtarëve ligjorë të ortakut themelues. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rastet ndarje pasurore mes bashkëshortëve, si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tij

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të ortakut të vetëm themelues do të bëhet me Vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë për veprime të shitjes apo transferime kapitali në forma të tjera sipas ligjit. Ortaku themelues i shoqërisë me vendim të tij mund të shtojë apo pakesoje kapitalin themeltar në çdo periudhë që e sheh të nevojshme, ne perputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu po me Vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet, pakësohet ose ndryshohet objekti i veprimtarisë së shoqërisë, sipas formës dhe objektit të parashikuar nga ligji shqiptar, pas miratimit nga organet shtetërore kompetente, nëse kjo kërkohet nga ligji.

Neni 7
ORGANI VENDIMARRES

Organi me i larte ne marrjen e vendimeve te shoqerise, deri sa kjo shoqeri te jete asambleja e ortakeve, me ortakët dhe pjesëmarrjen sipas percaktimeve te mesiperme. Ata vendosin per



emerimin, shkarkimin apo ndryshimin e administratorit (person tjetër jopronar), si dhe marrja e çdo vendimi tjetër që është në përputhje me ligjin.

Neni 8

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Per sa kohë që shoqëria do të jetë me ortak të vetëm, ky i fundit ka për kompetencë:

1. Te emerojë, shkarkojë apo të ndryshoj administratorin e shoqërisë.
2. Të japë pelqimin për emërimin apo shkarkimin e nëpunësve të lartë të administratës së shoqërisë apo punëmarrës të shoqërisë;
3. Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj;
4. Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej tij;
5. Te vendosë për zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit të shoqërisë.
6. Te vendosë ndryshimin e selisë, apo hapjen e filialeve të tjera të shoqërisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria "AgriConsult Group" sh.p.k, do të administrohet nga administratori Klaidi Bido. Në rast se ortakët vendosin të emerojnë një administrator të ri, jo ortak të shoqërisë, kompetencat e tij do të përcaktohen në aktin e emërimit. **Afati kohor për ushtrimin e këtij funksioni është 5 vite, me të drejtë rizgjedhje.**


Çdo rekomandim apo vendim i ortakëve të shoqërisë (në rast të shtimit të ortakëve) është i detyrueshëm për t'u zbatuar menjëherë nga Administratori jo pronar i shoqërisë. Me kalimin e afatit 5-vjeçar, administratori njofton ortakët ose Asamblenë e Ortakëve për përfundimin e detyrës (mandatit) të tij. Ortakët ose Asambleja duhet të vendosë brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit, mbi vazhdimin e mëtejshëm të funksionit të caktuar Administratorit. Në qoftë se brenda 20 ditëve nga dita e njoftimit ose Asambleja e Ortakëve nuk merr Vendim si dhe t'i kthejë përgjigje administratorit për vazhdimin ose jo të punës, ky i fundit e ushtron funksionin e tij automatikisht edhe për një periudhë tjetër 1-vjeçare.

Neni 10

ADMINISTRATORI

Administratori ka për kompetencë që:

- Të përfaqësojë dhe menaxhojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet e saj juridike, tregtare, administrative dhe ekzekutive brenda kompetencave;
- Të kryejë çdo veprim që e konsideron të arsyeshëm në interes të shoqërisë në bazë dhe në zbatim të ligjit;
- Të menaxhojë punën e shoqërisë dhe të udhëzojë personelin e shoqërisë apo të vendosë sanksione ndaj tyre në përputhje me kontratat e punës;
- Të nxisë kryerjen e veprimtarive tregtare të shoqërisë me persona fizike dhe juridike si dhe me të tretë për të realizuar objektin, qëllimin dhe strategjinë e shoqërisë;
- Të pranojë dhe të largojë nga puna punëmarrës në përpërputhje me dispozitat ligjore në fuqi, brenda nevojave dhe organikës së shoqërisë;



Neni 11

Ne rast emerimi te nje Administratori jo pronar te shoqërisë do te kete për detyrë:

- Të menaxhojë, të drejtojë e të organizojë në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomike-financiare;
- Të zbatojë vendimet e marra nga ortakut i vetëm ose Asambleja e shoqërisë, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- T'i paraqesë ortakut të vetëm ose Asamblesë në mënyrë të rregullt raportin e administrimit, të inventarit fizik dhe kontabël, bilancit dhe të llogarive vjetore brenda një afati 3-muaj pas mbylljes së vitit financiar paraardhës;
- Të përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për veprime me faj të kryera gjatë administrimit;
- Të drejttat dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare.

Neni 12

Për përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve shtetërore, administrative, gjyqësore ose të tretëve, shkresat nenshkruhen me firmen e administratorit, dhe duhet të vulosen dhe të protokollohen nëse është e mundur.

Neni 13

Në rast pengesash për ushtrimin e funksioneve si Administrator në rast sëmundje, aksidente, udhëtime të administratorit etj, Ortaku i vetëm mund të caktojë një administrator tjetër në këtë funksion.

Në rast se konsiderohet e nevojshme, Administratori ose ndonjë prej ortakëve të shoqërisë në rast të shtimit të ortakëve, thërret Asamblenë e shoqërisë për të caktuar Administratorin e saj.

Neni 14

VULA DHE STEMJA

Shoqëria ka vulën dhe stemen e saj, në të cilën është shkruar: Shoqëria "AgriConsult Group" sh.p.k, Vula ka formë drejtkëndeshedhe administrohet dhe disponohet nga Administratori i shoqërisë.

Shoqëria ka stemën e saj të veçantë të dallueshme nga shoqëritë e tjera. Të gjitha shkresat që formulohen dhe dalin nga shoqëria duhet të nënshkruhen nga administratori dhe të vulosen me vulën e shoqërisë.


Neni 15

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Veprimet e vitit ushtrimor mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Administratori dhe ortakut i vetëm cakton Ekspert Kontabël të Autorizuar për auditimin e llogarive të shoqërisë. E drejta e caktimit të ekspertit kontabël të Autorizuar në rastin e shtimit të ortakëve i takon Asamblesë së shoqërisë. Raporti vjetor i ekspertit përmban miratimin e bilancit të vitit ushtrimor paraardhës me të ardhurat, shpenzimet, fitimet dhe humbjet, të formuluar këto konform ligjit.

Neni 16

Ortakët e shoqërisë, do të vendosin për krijimin e fondeve rezervë nga të ardhurat neto të realizuara nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, për përdorimin e tyre sipas nevojave të saj. Shuma mund të jetë sa 1/20 e të ardhurave neto të shoqërisë për vitin financiar në vazhdim.



Neni 17
SHPËRBËRJA

Në çdo kohë për motive të ndryshme shoqëria mund të ndodhet përballë shpërbërjes. Për likuidimin e shoqërisë vendos, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë ose Gjykata, ku vendoset për mënyrën e likuidimit dhe procedura përkatëse në bazë të ligjeve në fuqi.

Shpërbërja e shoqërisë mund të kërkohet nga një ose disa kreditorë të shoqërisë, të cilët kërkojnë likuidimin e shoqërisë për mospërbushjen e detyrimeve ndaj tyre.

Likuidimi i shoqërisë mund të bëhet sipas rasteve të parashikuara në Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare, dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Neni 18

Për çështje, probleme apo procedura që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut, vlejné dispozitat e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare, seksioni për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe aktet e tjera ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj shoqërie, si dhe ligji Nr.9723 datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Statuti u përpilua në 4 kopje, me fuqi të njëjtë ligjore, një kopje do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ku do legalizohet shoqëria si person juridik dhe kopjet e tjera mbeten në dokumentacionet bazë të krijimit të shoqërisë "AgriConsult Group" sh.p.k,

ORTAKET E SHOQËRISE

Klaidi BIDO

Daniel SHANDRO

Franco SACCOCCI